



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 71-të, të mbajtur më 30.06.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1543/1 kundër Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës në Universitetin ----- në -----HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për shkak se nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare .

Lënda me numër 12-1543 të vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më datë 06.03.2020, u dorëzua denoncim për dyshime për punë të paligjshme të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Arkitekturës në Universitetin ----- në ----- dhe u formua lënda me numër 12-1543 të vitit 2020.

Në pajtim me pretendimet në denoncim, Fakulteti punon nga viti 2016, që tregon se fakulteti ka problem dhe profesorët nuk duan të punësohen në të njëjtën. Prandaj, thuhet se kishte katër profesorë, dy prej të cilëve ishin vëllezër, nga të cilët një në ndërtim, një në arkitekturë dhe një në lëndët e përgjithshme të matematikës, i cili nuk ishte pjesë e tre kuadrove, duke mos përmbushur kushtin e Ligjit të Arsimit të Lartë sipas të cilit fakulteti në kuadër të një universiteti mund të punojë vetëm nëse ka të paktën 10 persona në tituj mësimitor-shkencorë në marrëdhënie pune me kohë të plotë. Kërkuesi shprehu dyshime edhe për numrin e studentëve, domethënë sipas të dhënave të denoncimit, në katedrën e ndërtimit kishte tetë studentë aktivë, ndërsa punonjësit ishin tre profesorë dhe tre asistentë, ndërsa shteti katër vjet pagoi profesorë vëllezër dhe asistentë për dhjetë studentë, në katedrën e gjeodezisë kishte pesëmbëdhjetë studentë

aktivë dhe vetëm një asistent punonjës, ndërsa në arkitekturë kishte pesëdhjetë e shtatë studentë aktivë, dhe një profesor punonjës dhe tre asistentë. Për shkak të sa mësipërm, parashtruesi thekson se Fakulteti duhet të mbyllet, ndërsa KSHPK-ja si një organ shtetëror duhet të sigurojë që studentët të vazhdojnë studimet në ndonjë nga fakultetet e tjera të akredituara në shtet që plotësojnë kriteret ligjore.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja konstatoi se në denoncim nuk ka elemente të veprimit kompetent për shkak se nuk ka pretendime të qarta ose tregues të veprimeve të paligjshme ose të papranueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrës zyrtare, as nuk mund të sigurojë saktësimin e pretendimeve, duke pasur parasysh se parashtruesi është i panjohur.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: B.V.B.

Miratoi: NB, anëtar i KSHPK - së

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami

